REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 736/20
Datë/Datum. 30.09.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 622-20-2058-2-1-1

Sa i përket tenderit për: **Instalimi i ndriçimit publik dhe riparimi i ndriçimit publik ekzistues në Komunën e Prizrenit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

BM Group Sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Shkupi Bll.05 ,Linda Premium Residence, L9, pn , 10000 Prishtinë, Kosovë
(Adresa)

Prishtine — *(Vendi)*
10000 — *(Kodi postar)*

+383 49 247680 — *(Numri Telefonit)*
N/A — *(Numri i Faks-it)*

Bedri Gllareva
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

bedri.gllareva@bmgroup-rks.com; ***info@bmgroup-rks.com***
(Adresa elektronike)

30.09.2020
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

export import BM GROUP SH.P.K

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar "Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit te procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë si dhe Dosja e Tenderit janë publikuar me datën 18.05.2020 në faqen zyrtare e-prokurimi.rks-gov.net prej nga edhe i kemi shkarkuar Dosjen e Tenderit dhe Paramasën.

Dorëzimi i dosjes nga kompania jonë është bërë me datën 26.06.2020 në mënyrë elektronike përmes e-prokurimi.rks-gov.net. Procesi i hapjës së tenderit është bërë me datë 26.06.2020 nga ora 14:00.

Me datën 09.09.2020 AK ka publikuar "B58 028.NJOFTIM PER VENDIMIN E AK - Anulim" përmes platformës e-prokurimi.rks-gov.net.

Me datë 16.09.2020 përmes emailit dhe faqes së e-prokurimit kemi dërguar Kërkesën për rishqyrtim tek Ak.
Me datë 21.09.2020 përmes emailit dhe faqes së e-prokurimit kemi pranuar Përgjigjjen per Kërkesën për rishqyrtim nga AK. AK ka marrë vendim që të Refuzohet kërkesa për rishqyrtim dhe të vazhdohet me vendimin "B58 028.NJOFTIM PER VENDIMIN E AK - Anulim".

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☐ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ankesa jonë ka të bëjë me Ri-shikimin në përcaktimin e Operatorit Ekonomik fitues, kështu që mendojmë që AK :

PRANDAJ JU KENI SHKELUR LIGJINI E PROKURIMIT PUBLIK NE NENET E MËPOSHTME:

1. **NENI 62 e LPP-së - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit**
2. **NENI 69 e LPP-së- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**
3. **NENI 39 PIKA 8 e RROUP-se- Sqarimi i Tenderëve**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Faktet dhe Argumentet tona janë:

1. *Nuk është respektuar Neni 62 pika 1 e LPP-së (1. Autoriteti kontraktues mund të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet: të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit)*

Duke pas parasysh këtë nenë AK nuk ka mundur të anuloj aktivitetin e prokurimit pasiqë ne si OE jemi më të lirë se vlera e parashikuar për aktivitet.

2. *Nuk është respektuar Neni 69 pika 2.1e LPP-së (Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës-2.1 listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkënënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë) si dhe*

3. *Nuk është respektuar Neni 39 pika 8 e RROUP-se- (AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit" OE përmes sistemit të prokurimit elektronik, dhe OE duhet të dorëzojë përgjigjen e tyre tek AK në një dokument të shkruar me anë të sistemit elektronik – (Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave te prezantuara- Mund te kërkohen informata sqaruese) .*

Duke pasur parasysh këto NENE, AK ka mundur të bëj kërkesë për Sqarime të tenderit për dokumentet që si AK mendojnë që mungojnë, dhe jo të na diskualifikojnë pa arsye. Me anulim të aktivitetit AK ka bërë shkelje të Ligjit të Prokurimit dhe na ka dëmtuar neve si operator Ekonomik.

PROPOZIMI JONE:

APROVOHET ankesa e OE "BM Group" Sh.p.k si e bazuar.

ANULOHET Njoftimi dhe Vendimi i AK-së për anulim aktiviteti dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM.**

DETYROHET, autoriteti kontraktues që Rivlerësimi i ofertave të bëhet konform dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të FTD-së dhe të njoftimit për kontratë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) Një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
c) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë;
d) Kerkesa per rishqyrtim e dorezuar tek AK
e) Njoftim Mbi Vendimin E Autoritetit Kontraktues

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*